



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**

Berat më \_\_\_\_/06/2026

**RELACION**

**“Për ndryshim në vendimin e këshillit bashkiak nr. 101 datë 22.12.2025 “ Për miratimin e buxhetit të bashkisë Berat për vitin 2026 dhe PBA 2026-2028”, i ndryshuar (rialokim fondesh buxhetore**

Të nderuar këshilltarë!

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 40, pika 1, neni 41, pika c, 54, gërma “dh”, neni 64 gërma “c”, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 6, gërma “d”, neni 28, pika 5, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH” i ndryshuar me ligjin nr.56/2015 dhe ligjin nr.48/2018, VKM nr.175 datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, Ligji nr.26/2026 “Për disa shtesa dhe një ndryshim në Ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 14.01.2026 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”; VKB nr. 28 datë 30.03.2026 “Për miratimin e shërbimit të transportit me autobusë elektrikë e-buses, për caktimin e itinerareve, stacioneve dhe tarifës së biletës, si shërbim plotësues i transportit qytetas”, , Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 101 datë 22.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028” i ndryshuar,

Ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim projektvendimin për kryerjen e disa ndryshimeve të brendshme në buxhetin e vitit 2026 të Bashkisë Berat, konkretisht:

1. Rialokimin e fondeve buxhetore midis programeve buxhetore dhe njësive shpenzuese, në shumën totale prej 44,087,120 lekë.

**I. Rialokimi i fondeve buxhetore**

Ndryshimet e propozuara nuk sjellin rritje të totalit të buxhetit të miratuar për vitin 2026, por përfaqësojnë lëvizje të brendshme fondesh midis programeve buxhetore dhe njësive shpenzuese, me qëllim përdorimin sa më efikas të burimeve financiare dhe orientimin e tyre drejt nevojave reale të evidentuara gjatë zbatimit të buxhetit.

Rialokimet e propozuara janë rezultat i analizës së ecurisë së buxhetit për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2026 dhe të kërkesave të paraqitura nga drejtuesit e njësive shpenzuese, të cilët njëkohësisht janë edhe drejtues të ekipeve të programeve buxhetore.

Pakësimi i fondeve propozohet në disa zëra shpenzimesh për shkak të:

- krijimit të fondeve të lira pas përfundimit të procedurave të prokurimit, si rezultat i diferencës ndërmjet vlerës së planifikuar dhe vlerës së kontraktuar;
- ekzistencës së vendeve vakante në strukturat organizative të njësive shpenzuese;
- shtyrjes ose rishikimit të prioriteteve të disa ndërhyrjeve investuese;
- krijimit të mundësisë financiare për përmbushjen e nevojave të reja dhe prioritare të evidentuara gjatë ushtrimit të funksioneve të bashkisë.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Në këtë kuadër, pakësohen fondet në shumën 44,087,120 lekë, kryesisht nga fondet e pagave dhe sigurimeve shoqërore në Aparatin e Bashkisë, si rezultat i vendeve vakante në strukturë, nga kursimet e krijuara në procedurat e prokurimit për ndërhyrjen në infrastrukturën e Tregut Industrial, rehabilitimin e Varrezave të Dëshmorëve dhe investimet në infrastrukturën rrugore, si dhe nga fondet e planifikuara për projekte dhe bashkëfinancime në fushën e arsimit, sistemimin e ambienteve të jashtme në institucionet arsimore dhe aktivitetin kulturor “Xixëllonja”, i cili do të mbështetet financiarisht nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, si projekt fitues nga aplikimet e bëra pranë tij.

Fondet e krijuara si rezultat i këtyre kursimeve dhe rishikimeve propozohen të rialokohen për mbulimin e nevojave prioritare si më poshtë:

1. Në Programin “Shërbimet Publike, Infrastruktura dhe Emergjencat Civile”, shtohet fondi prej 20,000,000 lekë për Agjencinë e Shërbimeve Publike, për realizimin e ndërhyrjeve të mëtejshme në mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve urbane me asfaltim.

Gjatë vitit 2026, me fondin fillestar prej 48,000,000 lekë, janë realizuar ndërhyrje në akset rrugore “Maranjakët” (Lapardha), “Koli Vesho”, “Gjoroven-Ura e Veleshnjës”, “Baki Gjebrea”, “Antipatrea”, “Donika Kastrioti”, “Kala”, Çerdhja “Donika Kastrioti” dhe zona e Ish-Pjeshkores.

Nisur nga kërkesat e administratorëve të njësive administrative dhe nevojat e evidentuara në terren, fondi shtesë prej 20 milionë lekë do të përdoret për ndërhyrje në :

- rrugët e brendshme të lagjes “Donika Kastrioti” dhe
- në segmentin rrugor Karburanti “Gega Oil” – Rrethrrrotullimi i Bypass-it.

2. Në Programin “Arsimi dhe Kujdesi Social”, shtohen 2,600,000 lekë për fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore të Drejtorisë së Arsimit, në zbatim të Ligjit nr.26/2026 “Për disa shtesa dhe një ndryshim në Ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga i cili preken 111 punonjës arsimorë.

Gjithashtu, në kuadër të rishikimit të planit të investimeve në arsim, fondi prej 3,020,120 lekë i planifikuar për sistemimin e ambienteve të jashtme në godinat arsimore rialokohet për rehabilitimin e nyjeve sanitare në kopshte, mobilimin dhe shtrimin me parket të ambienteve të kopshteve, si dhe për blerjen e kompjuterëve dhe videoprojektorëve, me qëllim përmirësimin e kushteve të infrastrukturës arsimore.

3. Në Programin “Arsimi dhe Kujdesi Social”, shtohet fondi prej 467,000 lekë për Qendrën “Lira”, për mbulimin e shpenzimeve të personelit, si rezultat i shtimit të një pozicioni të ri pune (shofer) në strukturën e qendrës, miratuar me vendim të Kryetarit të Bashkisë, efektet financiare të të cilit nuk ishin parashikuar në buxhetin fillestar të vitit 2026.
4. Në Programin “Turizmi, Kultura dhe Sportet”, fondi i planifikuar për projektin “Xixëllonja”, në shumën 4,100,000 lekë, propozohet të rialokohet, duke qenë se ky projekt do të financohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Gjithashtu, në pamundësi të gjetjes së fondeve nga donatorë, dhe për shkak të afrimit të kohës së zhvillimit të eventeve propozojmë të shtohen fonde të tjera për të siguruar financimin e plotë të aktiviteteve artistike të miratuara nga Bordi Artistik. konkretisht për zhvillimin e aktivitetit “Berati Ëine & Stories – Festivali i Verës”, edicioni i pestë, me velrë



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**

të parashikuar 10,000,000 lekë dhe aktivitetit “Mangalem’s Shades” në vlerën 2,000,000 lekë. Shtesa neto e programit është 7,900,000 lekë.

Këto aktivitete kanë ndikim të drejtpërdrejtë në promovimin e vlerave kulturore, rritjen e atraktivitetit turistik të qytetit dhe gjallërimin e jetës artistike dhe ekonomike të Beratit.

5. Në Programin “Shërbimet Publike, Infrastruktura dhe Emergjencat Civile”, shtohet fondi prej 4,000,000 lekë në formën e transfertës për ndërmarrjen BCG Berat City Green , për mbulimin e kostove të operimit të shërbimit të transportit urban me autobusë elektrikë (e-buses), me qëllim garantimin e vijueshmërisë së shërbimit, promovimin e transportit publik të qëndrueshëm dhe përmirësimin e lëvizshmërisë urbane. Kjo bazuar edhe në VKB nr. 28 datë 30.03.2026 “Për miratimin e shërbimit të transportit me autobusë elektrikë e-buses, për caktimin e itinerareve, stacioneve dhe tarifës së biletës, si shërbim plotësues i transportit qytetas”.
6. Në Programin “Arsimi dhe Kujdesi Social”, shtohet fondi prej 1,500,000 lekë për mbështetjen e familjeve dhe individëve në kushte të vështira social-ekonomike, me qëllim përmbushjen e nevojave të evidentuara gjatë zbatimit të programeve të mbrojtjes sociale dhe forcimin e mbështetjes ndaj shtresave më në nevojë.

Në përfundim, rialokimi i propozuar nuk ndryshon balancën e përgjithshme të buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2026, përfaqëson një proces normal të menaxhimit financiar gjatë zbatimit të buxhetit, i orientuar drejt përmirësimit të performancës buxhetore, rritjes së eficiencës në përdorimin e fondeve publike dhe adresimit në kohë të nevojave prioritare të komunitetit.

Rishpërndarja e shpenzimeve kërkohet sipas strukturave buxhetore të paraqitura në tabelat më poshtë:

**Pakësime :**

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				36,467,000.00
2102001		AA102	Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse			8,160,000.00
2102001	05	AA102	V111AAA	600	Paga	3,000,000.00
2102001	05	AA102	V111AAA	601	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	500,000.00
2102001	05	AA102	V112AAB	600	Paga	2,000,000.00
2102001	05	AA102	V112AAB	601	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	330,000.00
2102001	05	AA102	V823AAA	600	Paga	2,000,000.00
2102001	05	AA102	V823AAA	601	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	330,000.00
2102001		AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile			20,807,000.00
2102001	05	AB102	P416AAB	231	Nderhyrje ne infrastrukturen e Tregut Industrial Berat	1,982,260.00
2102001	01	AB102	P416AAB	231	Nderhyrje ne infrastrukturen e Tregut Industrial Berat	2,379,900.00
2102001	05	AB102	P626AIA	231	Rehabilitim i Varrezave te Deshmoreve	817,200.00
2102001	05	AB102	P452AAV	231	Investime të reja në infrastrukturën rrugore përfshirë shp. për supervizime, kolaudime, shpronësime	15,627,640.00
		AC102	Arsimi dhe Kujdesi Social			7,500,000.00
2102001	05	AC102	V912AAD	231	Fond per projekte dhe bashkefinancime ne fushen e arsimit	5,000,000.00



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**

2102001	05	AC102	V923AAB	231	Objekte te Arsimit të Mesëm të Mirëmbajtura dhe Funktionale	2,500,000.00
<b>2102005</b>	<b>Drejtoria Arsimore Bashkia Berat</b>					<b>3,020,120.00</b>
<b>2102005</b>		<b>AC102</b>	<b>Arsimi dhe kujdesi Social</b>			<b>3,020,120.00</b>
2102005	05	AC102	P912ABZ	231	Sistemim I ambienteve te jashtme ne godinat arsimore te arsimit parauniversitar	3,020,120.00
<b>2102006</b>	<b>Qendra Kulturore "Margarita Tutulani"</b>					<b>4,600,000.00</b>
		<b>AF102</b>	<b>Turizmi, Kultura dhe Sportet</b>			<b>4,600,000.00</b>
2102006	05	AF102	V823AAA	602	Shpenzime per aktivitete kulturore, Aktiviteti "Xixelonjat"	4,100,000.00
2102006	05	AF102	V823AAC	231	Blerje pajisje dhe materiale logjistike	500,000.00
<b>Total Pakesime</b>						<b>44,087,120.00</b>

**Shtesa:**

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
<b>2102001</b>	<b>Bashkia Berat (Aparati)</b>					<b>5,500,000.00</b>
<b>2102001</b>		<b>AB102</b>	<b>Shërbimet Publike, Infrastruktura &amp; Emergjencat Civile</b>			<b>4,000,000.00</b>
2102001	05	AB102	V457AAB	604	Transferime tek BCG per mbulimin e kostove te transportit me e-buses	4,000,000.00
<b>2102001</b>		<b>AC102</b>	<b>Arsimi &amp; Kujdesi Social</b>			<b>1,500,000.00</b>
2102001	05	AC102	V014AAB	606	Transferta për Buxh. Familje& Individë në kushte të vështira social-ekonomike	1,500,000.00
<b>2102004</b>	<b>Agjencia e Shërbimeve Publike</b>					<b>20,000,000.00</b>
		<b>AB102</b>	<b>Shërbimet Publike, Infrastruktura &amp; Emergjencat Civile</b>			<b>20,000,000.00</b>
2102004	05	AB102	V626AAC	602	Rruge urbane e mirembajtur ne qytetet e NJVQV duke bërë kontrolle dhe ndërhyrje periodike për mbushjen e gropave, rregullimin e sinjalistikës; asfaltim .	17,620,100.00
2102004	01	AB102	V626AAC	602	Rruge urbane e mirembajtur ne qytetet e NJVQV duke bërë kontrolle dhe ndërhyrje periodike për mbushjen e gropave, rregullimin e sinjalistikës; asfaltim .	2,379,900.00
<b>2102005</b>	<b>Drejtoria Arsimore Bashkia Berat</b>					<b>5,620,120.00</b>
<b>2102005</b>		<b>AC102</b>	<b>Arsimi dhe kujdesi Social</b>			<b>5,620,120.00</b>
2102005	05	AC102	V912AAA	600	Paga	2,200,000.00
2102005	05	AC102	V912AAA	601	Shpenzime operative	400,000.00
2102005	05	AC102	V912AAB	231	Rehabilitim nyje sanitare ne kopshte	620,120.00
2102005	05	AC102	V912AAB	231	Mobilim dhe shtrim parketi ne kopshte	1,200,000.00
2102005	05	AC102	V912AAB	231	Blerje kompjutera+ video projektor	1,200,000.00
<b>2102006</b>	<b>Qendra Kulturore "Margarita Tutulani"</b>					<b>12,500,000</b>
		<b>AF102</b>	<b>Turizmi, Kultura dhe Sportet</b>			<b>12,500,000</b>
2102006	05	AF102	V823AAA	602	Shpenzime per aktivitete kulturore, Aktiviteti " Berati Wine&Stories"- Festivali i Veres edicioni i peste	10,000,000
2102006	05	AF102	V823AAA	602	Shpenzime per aktivitete kulturore, aktiviteti " Mangalem's Shades"	2,000,000
2102006	05	AF102	V823AAC	602	Blerje materiale per mirembajtje	500,000



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**

2102020	Qendra "Lira"					467,000.00
		AC102	Arsimi dhe Kujdesi Social			467,000.00
2102020	05	AC102	V043AAB	600	Paga	400,000.00
2102020	05	AC102	V043AAB	601	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	67,000.00
<b>Total Shtesa</b>						<b>44,087,120.00</b>

Për sa më sipër, kërkojmë miratimin e projektvendimit për ndryshimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.101, datë 22.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2026 dhe PBA 2026-2028”, i ndryshuar.

Ju faleminderit ,

Ervin CECA  
Kryetar i Bashkisë

Arisa TOSKA  
Sekretar i Përgjithshëm

Etleva DHIMA  
N/Kryetar i Bashkisë

Bledar ÇILI  
N/Kryetar i Bashkisë  
Drejtor i NJ.SH. Drejtoria e Bujqësisë

Rovena SHEHU  
Drejtor i Financës dhe Buxhetit

Petro SINJARI  
Drejtor i Drejtorisë Juridike

Sokol Toska  
Drejtor i Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Mjedisit

Klodiana HOXHA  
Drejtor i NJ.SH. Drejtoria e Arsimit Bashkia Berat

Joana MELËNGU  
Drejtor i NJ.SH. Agjencia e Shërbimeve Publike

Arben QAFA  
Drejtor i NJ.SH, Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”

Alma ZOGANI  
Drejtor i NJ.SH. Qendra “Lira”



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**KRYETARI**

**RELACION**

**MBI MIRATIMIN E PROJEKT DOKUMENTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR**  
**AFATMESËM 2026-2028, FAZA e RISHIKUAR**

Të nderuar këshilltarë!

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor, paraqitet për shqyrtim dhe miratim Dokumenti i PBA-së së Bashkisë Berat për periudhën 2027–2029. Dokumenti paraqet parashikimin e të ardhurave, shpenzimeve dhe prioriteteve kryesore të zhvillimit të bashkisë për tre vitet e ardhshme.

PBA 2027–2029 është hartuar mbi parimin e realizmit fiskal dhe qëndrueshmërisë financiare, me synim ruajtjen e ekuilibrit buxhetor, rritjen graduale të kapaciteteve investuese dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve publike për qytetarët.

## **I. TË ARDHURAT**

**Të ardhurat totale të Bashkisë Berat planifikohen në:**

- 1,718,834 mijë lekë në vitin 2027;
- 1,752,230 mijë lekë në vitin 2028;
- 1,794,402 mijë lekë në vitin 2029.

Pas uljes së vitit 2027, e cila lidhet kryesisht me mosparashikimin e trashëgimisë financiare nga viti i kaluar dhe uljen e granteve dhe financimeve të tjera, të ardhurat totale parashikohet të rriten me 33,396 mijë lekë ose 1.9% në vitin 2028 dhe me 42,172 mijë lekë ose 2.4% në vitin 2029.

**1. Të ardhurat nga burimet e veta planifikohen në:**

- 581,585 mijë lekë në vitin 2027;
- 581,968 mijë lekë në vitin 2028;
- 585,182 mijë lekë në vitin 2029,

Ky zë përbën pjesën më të madhe të të ardhurave të veta dhe paraqet stabilitet gjatë gjithë periudhës, duke reflektuar:

- Politika fiskale të pandryshuara;
- Fokus në përmirësimin e mbledhjes dhe administrimit;
- Kontroll më të mirë të informalitetit.

**2. Të ardhurat nga taksat e ndara, një tjetër burim i rëndësishëm financimi janë, të cilat planifikohen në:**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**KRYETARI**

- 70,390 mijë lekë në vitin 2027;
- 74,780 mijë lekë në vitin 2028;
- 79,243 mijë lekë në vitin 2029.

Të ardhurat nga taksat e ndara paraqesin rritje progresive dhe lidhen me:

- Ecurinë e të ardhurave në nivel kombëtar;
- Mekanizmat e shpërndarjes nga qeveria qendrore.

**3. Transfertat nga buxheti qendror planifikohen në:**

- 1,059,969 mijë lekë në vitin 2027;
- 1,094,831 mijë lekë në vitin 2028;
- 1,129,977 mijë lekë në vitin 2029.

**Brenda tyre:**

• **Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme planifikohet:**

- **Viti 2027:** 559,632 mijë lekë  
(+39,112 mijë lekë ose +7.5% krahasuar me vitin 2026)
- **Viti 2028:** 594,494 mijë lekë  
(+34,862 mijë lekë ose +6.2% krahasuar me vitin 2027)
- **Viti 2029:** 625,546 mijë lekë  
(+31,052 mijë lekë ose +5.2% krahasuar me vitin 2028)

**Transferta për rritjen e nivelit të pagave**

Për të gjithë periudhën 2027–2029 është parashikuar një transfertë e veçantë për financimin e rritjes së nivelit të pagave në shumën: **90,995 mijë lekë në vit**

Ky zë mbetet i pandryshuar krahasuar me vitin 2026 dhe garanton:

- Stabilitet në financimin e kostove të personelit;
- Zbatimin e politikave kombëtare të pagave në sektorët e transferuar.

• **Transferta e pakushtëzuar sektoriale planifikohet:**

- **2027:** 409,342 mijë lekë
- **2028:** 409,342 mijë lekë
- **2029:** 413,436 mijë lekë

Në krahasim me vitin 2026, kjo transfertë:

- Rritet me rreth **2% në vitet 2027–2028;**
- Rritet me rreth **3% në vitin 2029.**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**KRYETARI**

**Përfundime**

- Të ardhurat totale parashikohen me rritje të qëndrueshme gjatë periudhës 2027–2029;
- Transfertat nga buxheti qendror mbeten burimi kryesor i financimit; duke garantuar stabilitetin e buxhetit vendor;
- Të ardhurat nga burimet e veta janë të qëndrueshme, me potencial për përmirësim përmes forcimit të administrimit fiskal;
- Grantet e huaja mbeten një burim plotësues dhe i pasigurt.
- Struktura e të ardhurave është e balancuar dhe mbështet planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

**II. SHPENZIMET**

**Prioritetet kryesore të PBA-së 2027–2029 janë:**

- përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës urbane dhe rrugore;
- zhvillimi i transportit urban dhe krijimi i hapësirave shtesë të parkimit, në përgjigje të rritjes së fluksit turistik;
- rehabilitimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të ujitjes dhe kullimit;
- mbrojtja e mjedisit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i territorit;
- promovimi i turizmit, kulturës, historisë dhe trashëgimisë së qytetit;
- organizimi i aktiviteteve kulturore, artistike dhe sportive gjatë gjithë vitit;
- forcimi i mëtejshëm i shërbimeve publike dhe emergjencave civile.

Në zbatim të metodologjisë së re, shpenzimet janë planifikuar sipas programeve buxhetore, të cilat reflektojnë funksionet kryesore të bashkisë.

**1. AA102 – Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse**

2027: 212,708 mijë lekë

2028: 222,467 mijë lekë

2029: 225,259 mijë lekë

Siguron funksionimin administrativ dhe mbështetjen e të gjitha programeve të tjera.

**2. AB102 – Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile**

2027: 598,835 mijë lekë

2028: 617,308 mijë lekë

2029: 644,704 mijë lekë

Përfaqëson prioritetin kryesor të investimeve dhe shërbimeve publike, me peshën më të madhe në buxhet.

**3. AC102 – Arsimi dhe Kujdesi Social**

2027: 556,845 mijë lekë

2028: 560,403 mijë lekë

2029: 559,020 mijë lekë

Garanton vazhdimësinë e shërbimeve sociale dhe arsimore, me nivel të qëndrueshëm financimi.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**KRYETARI**

**4. AD102 – Bujqësia, Pyjet, Ujërat dhe Siguria Ushqimore**

2027: 73,872 mijë lekë

2028: 70,779 mijë lekë

2029: 72,528 mijë lekë

Mbështet zhvillimin rural dhe menaxhimin e burimeve natyrore.

**5. AE102 – Siguria dhe Mbrojtja e Territorit**

2027: 114,046 mijë lekë

2028: 115,365 mijë lekë

2029: 121,260 mijë lekë

Ky program mbulon funksione thelbësore që lidhen me garantimin e sigurisë publike dhe mbrojtjen e territorit, përfshirë shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, si dhe masa të tjera parandaluese dhe ndërhyrëse.

**6. AF102 – Turizmi, Kultura dhe Sportet**

2027: 146,528 mijë lekë

2028: 147,908 mijë lekë

2029: 147,631 mijë lekë

Synon rritjen e potencialit turistik dhe zhvillimin kulturor të qytetit.

**7. AG102 – Rezerva dhe Kontigjenca**

2027: 16,000 mijë lekë

2028: 18,000 mijë lekë

2029: 20,000 mijë lekë

Për periudhën e PBA-së është planifikuar edhe fondi i rezervës dhe kontigjencës, i cili do të përdoret për përballimin e situatave të paparashikuara, nevojave emergjente dhe financimeve shtesë për programe ekzistuese, gjithmonë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me miratimin e Këshillit Bashkiak.

### **III. PROCESI I KONSULTIMEVE PUBLIKE**

Në përgatitjen e këtij dokumenti janë zhvilluar dëgjesa publike në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Berat, për të garantuar përfaqësimin e komuniteteve si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**KRYETARI**

Gjithashtu, janë organizuar takime të posaçme me grupe interesi si bizneset, organizatat e shoqërisë civile, mësuesit, stafi shëndetësor, të rinjtë dhe pensionistët, për të mbledhur mendime dhe sugjerime mbi prioritetet buxhetore.

Procesi i dëgjësive është zhvilluar me transparencë të plotë, i dokumentuar me procesverbale, dhe sugjerimet e qytetarëve janë marrë në konsideratë në hartimin e këtij dokumenti. Kjo siguron që PBA 2027–2029 të mos jetë vetëm një planifikim administrativ, por edhe një produkt i përbashkët i qytetarëve dhe bashkisë.

Ky dokument përfaqëson fazën e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029 dhe përcakton kuadrin e përgjithshëm financiar dhe prioritetet kryesore të zhvillimit të Bashkisë Berat për tre vitet e ardhshme.

Në muajt në vijim, Bashkia Berat do të vijojë me fazën e dytë të PBA-së, e cila do të përfshijë detajimin e programeve buxhetore, përditësimin e projeksioneve financiare, integrimin e ndryshimeve që mund të rezultojnë nga aktet normative dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe përgatitjen e projektbuxhetit përfundimtar për vitin 2027 dhe parashikimet për vitet 2028–2029, i cili do t'i paraqitet sërish Këshillit Bashkiak për shqyrtim dhe miratim.

Për sa më sipër, kërkohet shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli Bashkiak i Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029 të Bashkisë Berat. (Faza e Parë).

Ju faleminderit ,

**Ervin CECA**  
Kryetar i Bashkisë



Berat, më: \_\_\_\_ . 06 .2026

**RELACION****MBI MIRATIMIN E BASHKËFINANCIMIT NGA BASHKIA BERAT TË PROJEKTIT  
“MBROJTJA NGA GËRRYERJA E LUMIT OSUM, RRUGA BYPASS, PRANË URËS SË  
BILÇËS”**

Të nderuar Këshilltarë,

Kryetari i Bashkisë Berat, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr. 53, datë 01.02.2023 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të akordimit të fondeve për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si edhe në veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile”, VKM nr 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, si dhe VKM nr. 384, datë 28.05.2026 “Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2026 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKB nr 107 datë 31.12.2025 “Mbi miratimin në parim të projektit “ Mbrojtja nga gërryerja e lumit Osum , rruga Bypass , pranë Urës së Bilçës”, VKB nr. 101 datw 22.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028”, paraqet për shqyrtim dhe miratim këtë relacion.

Gjatë periudhës së reshjeve intensive dhe përmbytjeve të ndodhura në muajin nëntor 2025, në segmentin e lumit Osum pranë Urës së Bilçës, në afërsi të rrugës Bypass, është konstatuar gërryerje progresive e bregut lumor dhe devijim i rrjedhës së lumit drejt trupit të rrugës. Kjo situatë përbën rrezik të drejtpërdrejtë për stabilitetin e infrastrukturës rrugore dhe sigurinë e përdoruesve të saj.

Për përballimin e kësaj problematike, Bashkia Berat ka hartuar projektin teknik “Mbrojtja nga gërryerja e lumit Osum, rruga Bypass, pranë Urës së Bilçës”, i cili parashikon realizimin e masave mbrojtëse inxhinierike, përfshirë ndërtimin e murit gabion, sistemit mbrojtës rip-rap dhe elementëve të tjerë të nevojshëm për stabilizimin e bregut dhe orientimin e rrjedhës së lumit.

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 107, datë 31.12.2025 “Mbi miratimin në parim të projektit “ Mbrojtja nga gërryerja e lumit Osum , rruga Bypass , pranë Urës së Bilçës”, është miratuar në parim projekti dhe aplikimi pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për sigurimin e financimit.

Në vijim të procedurës së aplikimit, me VKM nr. 384, datë 28.05.2026 “Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2026 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore”, projekti është shpallur fitues dhe është miratuar financimi nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore.

**BASHKIA BERAT**

Vlera totale e projektit është 44,977,207.04 lekë me TVSH, nga të cilat:

- 35,981,765.63 lekë (80%) financohen nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
- 8,995,441.41 lekë (20%) financohen nga Bashkia Berat, sipas kërkesave të programit të financimit.

Sipas VKM nr. 384, datë 28.05.2026, financimi nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është planifikuar në dy vite buxhetore, konkretisht:

- për vitin 2026: 16,191,794.53 lekë;
- për vitin 2027: 19,789,971.10 lekë.

Për mbulimin e pjesës së bashkëfinancimit prej 8,995,441.41 lekë, propozohet rialokimi i fondeve nga zërat e mëposhtëm të buxhetit të Bashkisë Berat:

Kod Institucioni	Programi	Artikull	Kod Projekti	Emërtimi i projektit	Vlera Lekë
2102001	Bashkia Qendra				8,995,441.41
2102001	AB102	231	P626ACT	Fond per Bashkefinancime ne projekte me financim te huaj ne fushen e sherbimeve publike	8,888,000.00
2102001	AB102	231	P626AIA	Rehabilitim i Varrezave te Dëshmoreve	107,441.41
				<b>Total Pakësime</b>	<b>8,995,441.41</b>

Shuma prej 107,441.41 lekë krijohet nga kursimi i realizuar gjatë procedurës së prokurimit për projektin “Rehabilitim i Varrezave të Dëshmorëve”, ku fondi i miratuar ishte 3,700,000 lekë, ndërsa kontrata është lidhur në vlerën 2,775,357.40 lekë.

Duke qenë se projekti adreson një problematikë të rëndësishme të sigurisë së infrastrukturës publike dhe të mbrojtjes nga rreziqet natyrore, si dhe duke qenë se është siguruar financimi në masën 80% nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, kërkohet miratimi nga Këshilli Bashkiak i bashkëfinancimit nga Bashkia Berat në vlerën 8,995,441.41 lekë, për realizimin e projektit “Mbrojtja nga gërryerja e lumit Osum, rruga Bypass, pranë Urës së Bilçës”.

Për sa më sipër, propozojmë miratimin e projektvendimit përkatës.

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj.

**KRYETARI I BASHKISË**  
**ERVIN CECA**



**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL**

**RELACION**

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE**  
**FINANCIARE NË RASTE TË VEÇANTA ZNJ. FATIME KOVAÇI.**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026, bazuar në relacionin e paraqitur nga drejtoria e Shërbimit Social, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, VKB-së nr.3, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.101, datë 22.12.2025 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2026 dhe PBA përfundimtare 2026-2028”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”.

**JU RELATOI:**

Të nderuar këshilltarë,

**Znj. Fatime Kovaçi** jeton në Rajonin nr. 3, lagjja “Donika Kastrioti”, në një banesë private e tipologjisë 2+1, në gjendje të amortizuar. Në banesën ku jeton znj. Kovaçi ka probleme të theksuara lidhur me kushtet e banimit, prezencë të lartë të lagjështisë dhe munges orendish shtëpiake, gjë e cila sjellë pasoja në stilin e jetesës. Aktualisht znj. Kovaçi jetonë me djalin e saj z. Elton Kovaçi i cili ka probleme shëndetësore (çertifikata bashkëngjitur). Nga strukturat e shërbimit social kryefamiljarja është identifikuar prej vitesh si rastë me probleme të theksuara social-ekonomike, gjithashtu dhe shëndetësore gjë e cila pasqyrohet qartë dhe nga



dokumentacioni i administruar (vërtetim nga institute të sigurimeve shoqërore). Znj. Kovaçi vuan nga një diagnozë e rëndë Cor Pulmonar Kronik, SPOK i formës së rëndë. Situata e mësipërme shëndetësore por dhe ajo social-ekonomike kanë shkaktuar penges të mëdha në të jetuar si dhe në plotësimin e nevojave bazike. Lidhur nga kërkesa e bërë nga znj. Fatime Kovaçi, me Nr. 200 Prot, datë 13.02.2026, vlerësimeve të here pas herëshme nga strukturat e Shërbimit Social kushteve aktuale shëndetësore të rënduara, të cilat kanë një prognozë në regres drejtoria e Shërbimit Social vazhdimisht ka qenë në mbështetje të znj. Kovaçi ku ajo është mbështetur në:

1. Trajtimin me ndihmë ekonomike nëpërmjet fondeve të drejtorisë së Shërbimit Social.
2. Mbështetje të vazhdueshme me paketa ushqimore-higjienosanitare.
3. Referim në ofj-të e ndryshme si dhe ato ato me bazë fetare.
4. Referim, mbështetje dhe aplikim për rehabilitimin e banesës si familje në nevojë.
5. Mbështetje nga politikat lokale si rastë i vacant për fatkeqësi.

Për sa më sipër duke u njohur me rastin ndër vite si dhe vazhdimisht mbështetur nëpërmjet strukturave tona, vizitave të here pas hrshme në familje vihet re që znj. Kovaçi ka nevoja imediate për mbështetje pasi aktualisht ka dhe debi përse i përket furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm. Gjithashtu diagnoza që ka, nga nga dita në ditë bënë regres dhe kërkohen medikamente specifike për tu përmisuar. Duke parë në dinamikë të gjitha problematikat drejtoria e Shërbimit Social: ***Të ndodhur në këto kushte duke u bazuar dhe në kërkesën e bërë nga znj. Fatime Kovaçi, vlerësimin social-ekonomik mbi nevojat nga strukturat e Shërbimit Social, vështirësitë social-ekonomike, kushtet ku jeton dhe dokumentacionin shëndetësor të paraqitur, propozojmë që znj. Fatime Kovaçi të mbështetet në masën e 70.000 (shtatëdhjetë mijë) lekë .***

Bashkëngjitur gjeni:

1. Dokumentacion shëndetësor.
2. Çertifikatë familjare.
3. Vlerësimi social-ekonomik nga administrator i N.E.
4. Kërkesën pranë zyrës me një ndalesë.

## DREJTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati